Hyrja në shkollë do të:
- ofrojë përvoja të reja për fëmijën tuaj
- ndryshojë ritmin e jetës së tij dhe të familjes (orare fikse, pushimet shkollore, lodhje, pushimi i pasdrekes etj.)

Kontaktoni pediatrin, një specialist ose shkollën në rast dyshimesh ose nevojash të veçanta.

Ju do të gjeni të gjitha informacionet e nevojshme në faqen e internetit: **www.vevey-ep.ch**

Bureau de l'intégration

Albanais

# MIRËSEVINI NË SHKOLLË!

Hyrja e fëmijës tuaj në shkollë është fillimi i një udhëtimi të gjatë…
Për ta bërë më të lehtë këtë, roli juaj si prindër është thelbësor.

Një partneritet familje-shkollë është garancia e shkollimit harmonik!

Vizioni juaj pozitiv për shkollën do ta ndihmojë atë gjatë shkollimit të tij.



## PËR TY QË MË SHOQËRON :



Tregomë mua histori, kujtime për familjen dhe anekdota

Përdorni me mua shprehje të mirësjelljes (të lutem, faleminderit, mirëdita etj.)

Merr kohë për të biseduar me mua, të më bësh pyetje dhe të më dëgjosh

Më lër të shkoj vetëm në banjë, të fshihem, të vishem dhe të laj duart

Më inkurajo të luaj me fëmijët e tjerë dhe të ndaj lodrat me ta

Le të marrim kohë për të veshur xhaketën time, për të mbyllur zinxhirin, për të mbathur këpucët e mia

Inkurajomë mua që t'ia dal vetë, të bëj aktivitete dhe t'i çoj ato deri në fund

Më shoqëro që t'i rregulloj lodrat e mia ose ato që kam përdorur

Më ndihmo që të përdor fjalë për ato që ndiej (emocionet e mia)

Të gatuajmë së bashku, ta shtrojmë tavolinën e ta rregullojmë shtëpinë bashkë

Të përdorim materiale (gërshërë, lapsa, objekte të vogla, plastelinë, puzzles etj)

Le të shkojmë në bibliotekë dhe të luajmë në bibliotekën e lodrave

Më merr në shëtitje në park, në pyll, buzë liqenit etj.)

Më lër të zbuloj lagjen time, qytetin tim

Deri te shkolla, ta bëjmë rrugën në këmbë

Le të bëjmë aktivitete të ndryshme përgjatë stinëve për të lëvizur (të kërcejmë, të ngjitemi, të vrapojmë, të lëkundemi etj)

Të kërcejmë së bashku. Le të bëjmë një aktivitet sportiv të dy






Fëmija juaj ka nevojë për praninë tuaj, të ndajë me ju përvojat e reja dhe për inkurajimin tuaj...



